



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 302/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Rafet Haxhaj, kryesues, Nehat Idrizi dhe Vllastimir Dimiç, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e znj. Djulizara Serdanoviq kandidate për deputete në Parlamentin e Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Bosnjačka Stranka Demokratske Akcije Kosova (BSDAK) nga fshati Kashicë komuna e Istogut, që ka të bëjë me tërheqjen nga lista e kandidateve, në seancën e mbajtur me datë 02.12.2010 mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë apeli si i pasafatshëm

ARSYETIMI

Znj. Djulizara Serdanoviq kandidate për deputete në Parlamentin e Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik BSDAK nga fshati Kashicë komuna e Istogut, ka parashtruar apel për tërheqje nga lista e kandidateve për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Parashtruesja e apelit ka deklaruar se nga informatat që i ka marrë nga disa miq të saj është njoftuar se gjendet në listën e kandidatëve për deputete nga radhët e BSDAK-se, duke deklaruar me përgjegjësi të plotë morale, penale dhe materiale se asnjëherë nuk ka qene në dijeni në lidhje me ndonjë aktivitet të saj politik që ka të bëjë me zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010.

Parashtruesja e apelit kërkon që PZAP-i të shqyrtoj apelin e saj dhe të bëjë tërheqjen nga lista e kandidateve për Zgjedhjet Parlamentare të Kosovës

FAKTET

PZAP ka pranuar një apel më datë 30.11.2010 nga Djulizara Serdanoviq kandidate për deputete në Parlamentin e Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik BSDAK nga fshati Kashicë komuna e Istogut, e cila kërkon tërheqjen nga lista e kandidateve për deputete nga ky subjekt politik.

Parashtruesja e apelit ka pohuar që kandidimi i saj është bërë duke e falsifikuar dhe duke e regjistruar emrin pa pëlqimin e saj, pasi që ajo nuk ka pasur kurrfarë bisedime me asnjë prej subjekteve politike dhe as me BSDAK-ën dhe se për futjen në listën zgjedhore nevojitet të plotësohet edhe formulari për gjendjen pronësore. Me këtë rast, sipas kandidates, asaj iu ka shkelur reputacioni si dhe iu ka shkaktuar dhimbje shpirtërore.

ANALIZË

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (Nr. 03/L-073),

Neni 122 pika c) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) përcakton:

Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të cilat janë prekur nga cilat do vendime të më poshtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apeloj atë vendim në PZAP brenda 24 orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetë (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli.

c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;

Lista e kandidatëve konsiderohet të jetë e certifikuar nga KQZ-ja në kohën e tërheqjes së shortit më 20 nëntor 2010, në ora 17:00 ndërsa afati për parashtrim të apelit në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë pas certifikimit gjë që nuk e ka bërë znj. Djulizara Serdanoviq nga BSDAK-ja.

Sipas dispozitës së lartcekur PZAP-i konstaton se apeli është i pasafatshëm, sepse apeli në PZAP është pranuar më datë 30.11.2010, ndërsa afati për parashtrim të apelit në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 302/2010 më datën 02.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

